

VENDIM
Nr.49, datë 3.2.1997

PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR RIKONSTRUKSIONIN E BURGUT TË BURRELIT

Duke u nisur nga gjendja e jashtëzakonshme e krijuar si pasojë e mosfunksionimit të Institucionit të Riedukimit në Kavajë dhe vënies në efikasitet të burgut të Burrelit, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë prokurimin e drejtpërdrejtë për rikonstruksionin e godinës së burgut të Burrelit me firmën "DEA" për shumën deri në 20 milionë lekë.
 2. Fondi prej 20 milionë lekësh sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe 5 milionë lekë për pajisjet e brendshme të burgut do të përballohen brenda fondeve buxhetore të vitit 1997 për Ministrinë e Drejtësisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi